



## KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Nr. 417 Prot.

Vau Dejës, me 19 .01 .2024

**Lënda:** Njoftim për mbledhjen e Këshillit Bashkiak Vau Dejës

**Drejtuar:** Anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” neni 53 pika 4, neni 56 pika 2, neni 57 pika 2 germa c, ju njoftojmë se mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës zhvillohet ditën e Premte me datë 26.01.2024, ora 14:00. Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës, Njësia Administrative Bushat.

**Me këtë rend dite:**

1. Projekt vendim për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2024.
2. Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2023.
3. Projekt vendim për anulimin e procedurave të privatizimit për ish magazinat e H/C Vau Dejës transferuar në pronësi të Bashkisë Vau Dejës, prishjen e tyre dhe miratimin e projekt idesë për rivitalizimin e qendres së qytetit Vau Dejës.
4. Projekt vendim për konvertimin e numërit të taksive 4+1 në taksë 8+1
5. Projekt vendim për miratimin e linjave të rregullta rrethqytetase të transportit të udhëtarëve.
6. Projekt vendim për miratimin e listës së ngastrave /nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim për vitin 2024.
7. Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje Bari dhe e pyjeve që kulloten për vitin 2024
8. Projekt vendim për dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit, të sipërfaqes prej 0.315 ha, pjesë e pasurisë nr.22, Zk nr 1100, e llojit “Kullotë”, në fshatin Barbullush, Njësia Administrative Bushat, pronë e Bashkisë Vau Dejes. “Për mbarështimin e faunes së egër dhe gjahut”.
9. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 0.6012 ha “ për agropylltari në ekonominë pyjore Drin, Gjader, Kirë.
10. Projekt vendim për dhënie titulli “Qytetar Nderi” i Bashkisë Vau Dejës, Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Z.Bajram Begaj.
11. Të ndryshme.

Komisionet e këshillit do mblidhet ditën e Ejte, datë 25.01.2024 ora 09.00 pranë Nj.A Bushat.



1.Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut

Znj.Albina Livadhi, Znj.Meliha Zyberaj, Znj.Paola Pleshaj

2.Komisioni i bujqësisë, pyjeve, menaxhimit të ujërave, mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit.

Z.Kastriot Shkjau, Znj.Mirela Vasija, Z.Aleko Dodani

3.Komisioni i kultures, trashëgimisë kulturore, dhënies së titujve, emërtimeve.

Znj.Paola Pleshaj, Z. Ermir Tahiri, Znj.Rregjinë Shelqetja

4.Komisioni i shërbimeve publike, transportit, lëvizshmërisë mjedisore, parqeve dhe rekreacionit, parkingjeve.

Z. Frano Prenga,Z. Samed Hasmeqaj, Znj. Vjollcë Zagani

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

